

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Kreu Rreth Nesh Njoftime Legjislacion Si Pranohen Ankesat Programi i Transparencës
RESIJ  

BY ILD 29 MAJ, 2024 PËR MEDIAT



Këshilli i Lartë Gjyqësor ka pranuar në seancën e sotme dëgjimore, kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për procedim disiplinor me masën 'Shkarkim nga detyra' për magjistraten Z.V., gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Kreu Rreth Nesh Njoftime Legjislacion Si Pranohen Ankesat Programi i Transparencës
RESIJ  

Hetimi disiplinor i kryer nga inspektorët e ILD-së konkludoi se gjyqtarja është gjetur fajtoare dhe është dënuar nga Gjykata e Posaçme Shkallës së Parë dhe ajo e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/ç të Kodit Penal.

Ushtrimi i parregullt i detyrës nga ana e magjistrates, edhe për vetë natyrën e faktit penal të konsumuar, përbën shkelje shumë të rëndë disiplinore, e që ka sjellë pasoja për dhënien e drejtësisë, ka diskredituar rëndë figurën, autoritetin, dinjitetin si dhe është dëmtuar rëndë besimi i publikut te magjistrati dhe tek organet e drejtësisë.

Inspektorët e ILD kërkuan caktimin e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra”, kërkesë që u pranua nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

NJOFTIM

Për të lehtësuar edhe më shumë procesin e ankimimit, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë sjell një formë të re, më të thjeshtuar të ankesës, që qytetarët apo institucionet mund të paraqesin për shkelje të dyshuara nga ana e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri.

Ky shënim shpjegues i procedurës shoqërohet me shembuj konkretë të vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për secilin nga kriteret, të përcaktuara në ligj mbi pranueshmërinë dhe shqyrtimin e ankesave.

Për më shumë informacion, ju lutem klikoni këtu.

Faqe

Kreu